



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË

RELACIONI TEKNIK


“HARTIMIN E STUDIM PROJEKTIMIT PËR OBJEKTET E
ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DHE EDUKIMIT”

OBJEKTI RIKONSTRUKSIONI I SHKOLLES MESME
BELSH "SAMI FRASHERI", BASHKIA BELSH.ELBASAN.

"ZENIT-06 SH.P.K

Rr. Myrteza Topi
Ndertesha 18 Hyrja 7 Ap .38
Tirane – Shqiperi

Tel: 0692056525
Tel: 0695647337
Email: zenit06@live.com
Email: fehzotarba@yahoo.com



TIRANE 2016

1. INFORMACION I PERGJITHSHEM

- Hyrje

Programi i Arsimit Parauniversitar edhe Edukimitka në qendër të tij hartimin e politikave në përmirësimin e infrastrukturës arsimore dhe kushteve të mësimdhënies.

Politika e programit ka si qëllim prioritar, propozimin dhe hartimin e projekteve të Qeverisjes Vendore për ndërtimin e godinave të reja shkollore dhe parashkollore në të gjithë territorin e Belshit të destinuar si sheshe të lira, për shkak të rritjes së demografisë dhe zhvillimit ekonomik e social duke synuar kështu rritjen e kapaciteteve të arsimit të përgjithshëm parashkollor e shkollor .

**Objekti: Rikonstruksioni I Shkolles Mesme Belsh "Sami Frasheri",
Bashkia Belsh.Elbasan.**

Vendodhja E Objektivit

Zona ku do të ndertohet ndodhet brenda territorit administrativ te Bashkise Belshit,
Siperfaqja e marre ne studim ka nje forme te shtrire ne trajte katrore

- Pershkrimi i gjendjes aktuale te objektit

Kjo shkollë është ndërtuar që në vitin 1981 dhe që nga ky vit nuk ka pasur asnjë rikonstruksion. Godina e shkollës është 4 katëshe dhe është i vetmi gjimnaz i cili i shërben një numri të konsiderueshëm nxënësish të kësaj zone, terrene sportive mungojnë, sistemi I ngrohjes mungon dhe duke u nisur nga amortizimi në tërësi, kjo shkollë ka nevojë të domosdoshme për investim.

Pamje te gjendjes ekzistuese te shkolles









2. PROJEKTI ARKITEKTONIK

Pershkrimi i nderhyrjes per rikonstruksionin

Grupi i projektimit pas vizites ne objekt dhe analizes qe i beri gjendjes ekzistuese mbeshtetur dhe ne kerkesat e detyres se projektimit pa te pershtatshem ta orientoje punen per rikonstruksionin e objektit ne keto drejtime:

1. Shtimi i siperfaqeve te godines ekzistuese, ndertimin e nje palestres te re ne sheshin e shkolles, permiresimi i kushteve ne te dhe
2. Sistemimi i territorit

Ne skajin veri-perendimor te oborrit parashikohet ndertimi i palestres se re dhe ambienteve te saj ndihmese, qe zhvillohen ne dy kate.

Ne objektin ekzistues eshte parashikuar zgjerimi i korridorit duke hequr ambientet ne njeren ane te tij. Gjithashtu parashikohet ndertimi i shkalles se emergjences dhe spostimi i banjove. Hyrja kryesore e shkolles spostohet ne qender te godines.

Per piken e dyte

Vendosja e shtesave dhe palestres eshte bere e tille qe te mos krijoje hapësira te pa shfrytëzuara. Ne hapësiren e lire qe mbetet jane vendosur terrenet sportive, sheshe te lira pjeserisht te mbuluara per rreshtim dhe aktivitete artistike. Me spostimin e hyrjes perftohet nje siperfaqe ne te cilen vendoset nje shesh per rreshtimin e nxenesve dhe dy hapësira te gjelberuara per rekreacion.

- Zgjidhja funksionale

Holli kryesor i shkolles i vendosur ne qender te godines ka dy hyrje qe sherbejne per lidhjen e shkolles me oborin e perparme dhe ate te pasem, ai eshte konceptuar qe te jete i lirshem dhe i bollshem. Holli dhe koridoret e gjera ne krahet e tij mendohet si nje hapësire e vetme dhe do te sherbeje jo vetem si nje vend grumbullimi e qarkullimi, por dhe si nje hapësire e lirshme ekspozimi te puneve te nxenesve duke qene se eshte i pershkrueshem gjate gjithë periudhes kohore te funksionimit te shkolles. Panelet e ekspozimit mund te vendosen ne menyre te lirshme dhe te ndryshueshme duke i dhene hollit gjalleri dhe larmi te trajtimit te hapësires se tij.

Korridori i zgjeruar ne te gjithë gjatesine e tij krijon mundesine per nje qarkullim komod te fluksit te nxenesve. Ambientet e mesim dhenies si laborator dhe klasa jane ambientet qe zene pjesen me te

madhe te katit perdhe. Nyjet h-s jane te vendosura ne fundin e korridorit, por duke qene lehtesisht te arritshme per nxenes dhe mesues. Ne katet e sipërme blloqet e tualeteve shoqerohen me nje nyje te posacme per mesuesit. Ne anen tjetër te koridorit Ne kete kat eshte parashikuar nje ambient per n/drejtor.

Ne katin e pare kemi administraten te perqendruar pikerisht ne shtesen mbi kollonade, ambjenti i madh qe krijohet mbi hyrjen e katit perdhe eshte parashikuar per biblioteke. Ne hapësiren qe krijohet mes administrates dhe bllokut te shkalleve ezistuese do te sherbeje per sherbim shendetsor. Pjesa tjetër e ambjenteve zihen nga klasa dhe laboratore, nyjet h-s.

Ne katin e dyte kemi vetem ambjente te mesim dhenies, klasa dhe laboratore, si dhe nyjet h-s. Ne hapësiren qe krijohet mes administrates dhe bllokut te shkalleve ezistuese eshte parashikuar nje amient per n/drejtor.

Ne katin e trete jane parashikuar klasa mesimdhenie, nyjet h-s, zyre e IT si dhe korridori qe ben te mundur lidhjen e ketyre ambjenteve . Ky korridor ndertohet mbi muraturen ekzistuese te katit te dyte te godines, ajo ndertohet me materiale te lehtesuara.

Hyrja per ne palester behet nga oborri i brendshem i krijuar rishtazi pas pozicionimit te shtesave anesore i cili te nxjerr dhe tek terrenet sportive.

RELACIONI TEKNIK

U PERGATITEN NGA GRUPI I INXHINIEREVE

Ing. Rexhep TARBA

Ark.Fejzulla TARBA

Ark.Rajmonda DAJA

PËR “ZENIT-06” SH.P.K.

ADMINISTRATORI

Ing. Rexhep TARBA

